



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA BERAT
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRËNDSHËM

Nr. _____ Prot.

Berat, më _____.07.2022

K O N F I R M O H E T
KRYETARI I BASHKISË
ERVIN DEMO

M E M O

PËR: Z. ERVIN DEMO KRYETARI I BASHKISË BERAT .

NGA : Z. Xhevahir Muzhaka dhe znj. Orieta Hysanj,
Audit në Sektorin e Auditimit të Brëndshëm Publik të Bashkisë Berat.

SUBJEKTI: Auditimi i plotë i ushtruar në “F.K.Tomori 1923” SH.A ka si objekt “Ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare per periudhën 01.01.2019-31.12.2021.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e rekomandimeve për një përmirësim të punës dhe ofrimin e sigurisë për titullarin që F.K.Tomori 1923 shpërndan, funksionon mbështetur në ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet, rregullat e komunikimit, politikat, kontratat të nënshkruara dhe marrëveshjet, e miratuara nga ana e organeve drejtuese të SH.A.te F.K.Tomori 1923.

Baza ligjore e veprimtarisë së shoqërisë janë:

- Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Grupi i auditimit i përberë nga z. Xhevahir Muzhaka e znj. Orieta Hysanj auditë në Sektorin e Auditimit të Brëndshëm në Bashkinë Berat e realizoi këto detyra nga data 11.04.2022 - 05.05.2022.

Konkluzion :

Në veprimtarinë e F.K.Tomori 1923 shpërndan Berat mbetet shumë për të bërë nga menaxhimi dhe duhen të merren masa konkrete për realizimin e tregësive ekonomike të një SH.A ndjekjen dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë është:

-Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Reth projekt raportit nga ana e subjektit të audituar janë bërë 4 observime nga të cilat është marrë parasysh një observacion dhe 3 të tjera nuk janë marrë parasysh.

Mbi bazën e kthimit përgjigje të observacioneve kemi hartuar Raportin Final të auditimit.

Sipas pikave të programit kemi:

I. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

Nga 10 (dhjetë) rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm janë zbatuar 6 (gjashtë) rekomandime dhe janë në proces zbatimi 4 (katër) prej tyre. I detajuar zbatimi i rekomandimeve të Kap I-re.

II. Sistemi e funksionimit te shoqerise aksionere, organet drejtuese.

Shoqeria Aksionere” Futboll Klub Tomori 1923” si me shoqeri me kapital 100% ne pronesi te qeverisjes vendore eshte krijuar me VKM nr.33 date. 26.07.2011 i Keshillit Bashkiak :“Per pjesemarrjen e Bashkise Berat si Aksioner i vetem ne themelimin e “FK Tomori 1923” SH.A Berat.

Shoqeria Aksionere e F.K.Tomori funksionon ne baze te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, si dhe te Ligji Nr.79/2017 “ Per Sportin” i.

Objekt i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Organizimi i aktiviteteve sportive ne fushen e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir per sportin e futbollit si dhe pjesmarja ne garat sportive te organizuara nga Federate Shqiptare e Futbollit.

Keshilli mbikqyres i Sh.A. F.K Tomori eshte i perbere prej 3 anetare. Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres behet me miratim te Asamblese ne perputhje me parashikimin e pikes 1 te nenit 160 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Nga auditimi i dokumentacioni i keshillit mbikqyres rezulton si ai eshte i invertazuar dhe i arshivuar.

Nga auditimi u konstatua :

Gjetje nr 1

Keshilli mbikqyres nuk ka miratuar programe vjetore per veprimtarine e tij ne kundersizim me Udhezimin nr.318 dt.08.04.2009 “Per emerimin funksionimin dhe shperblimin e keshillit mbikqyres ne shoqerite anonime shtetore,pika III, 1,si dhe nuk ka mare ne analize cdo tre muaji gjendjen financiare te shoqerise .

Rekomandim nr 1; Keshilli mbikqyres te miratoj programin vjetor tw veprimtarise se tij ne perputhje me Udhezimin nr.318 dt.08.04.2009 “Per emerimin funksionimin dhe shperblimin e keshillit mbikqyres ne shoqerite anonime shtetore, pika III, 1,si dhe te merret ne analize te tij veprimtaria ekonomilo financiare e F.K Tomorit cdo tre muaj duke i dhene prioritet te ardhurave te krijuara nga shitja e biletave te futbollit.

III.Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.

Për vitet 2019 - 2021 buxheti i Sh.A.FK.Tomori është vendimuar me VKB-të përkatëse të cdo viti buxhetor, të pasuruara me ndryshimet gjatë vitit buxhetor në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 ”Për Vetëqeverisjen vendore”. Vendimet e Këshillit Bashkiak për cdo vite buxhetor.

Fondet e buxhetit tranzit te Bashkise Berat per periudhen e auditimit 2019-2021, Financuar nga Bashkia Berat sipas viteve, paraqiten si me poshte:

Viti 2019 financuar 24.550.000 leke,

Viti 2020 financuar 25.000.000 leke,

Viti 2021 financuar 33.000.000 leke

F.K.Tomori 1923 ne funksionin e vete si shoqeri aksionere ka arketuar dhe te ardhura nga shitja e biletave, shitja e lojtareve dhe te ardhura te tjera, konkretisht:

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Shitje biletash	Shitje biletash	Shitje biletash
30,000	8,000	1.237.417

Pjesen me te madhe te shpenzimeve te Sh.A. F.K.Tomori e zena paga dhe bonus fillestar, ku per vitin 2019 jane shpenzuar 6.790 mije leke, per vitin 2020 jane shpenzuar 10.821 mije leke dhe per vitin 2021 jane shpenzuar 14.256 mije leke, ose jane shpenzuar per vitin 2020 fondi prej 4.031 mije leke ose 59.5 % me shume se viti 2019 dhe per vitin 2021 jane shpenzuar 3.435 mije leke me shume se viti 2020 per paga te ekipit ose 31 % me shume se viti 2020.

Per vitin 2021 te ardhurat nga F.K.Tomori jane ne shumen 1.237 mije leke, ndersa shpenzimet e vitit 2021 zene shumen 34.237 mije leke, ose realizimi i shpenzimeve nga te ardhurat ze vetem 3.6 % te shpenzimeve te vitit 2021 kurse pjesa tjetere prej 96,4 % funksionon me te ardhura nga buxheti i bashkise.

Gjetje Nr 2:

Nga ana e menaxherit te shoqerise aksionare (shoqeri qe funksionon 96. % me te ardhura buxhetore) te identifikojte dhe te krijojte rregjistrin e riskut, te vleresojte dhe kontrolloje risqet qe vene ne rrezik arritjen e objektivave (krijimi i te ardhurave nga shitja e biletave dhe te ardhura te tjera) dhe realizimin me sukses te veprimtarive te strukturave qe ata drejtojne ne mbeshtetje te Ligjit nr 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin ” neni 11, pika 2.

Rekomandimi Nr 2: Ne zbatim te Ligjit nr 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin ” neni 11, pika 2 lind si detyre e menaxherit te Shoqerise Aksionare (shoqeri qe funksionon 96 % me te ardhura buxhetore) te identifikojte dhe te krijojw rregjistrin e riskut, te vleresojw dhe kontrolloje risqet qw vene nw rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses te veprimtarive te strukturave qe ata drejtojne.

IV. *Sistemi i menaxhimit te burimeve njerëzore, rregullorja e brendshme, pagat e shtesat mbi page.*

1. Zbatimi i strukturës organizative dhe i tabelës së pagave.

Nga auditimi i dokumentacionit për strukturën organizative të administrates se F.K.Tomori 1923 rezulton se statusi i punonjesve te kesaj qëndre rregullohet sipas Kodit te Punes per te gjithë punonjesit dhe nivele i pagave te tyre eshte i rregulluar sipas Vendimit nr 6343, date 14.11.2017 te aksionerit te vetem themelues i perfaqesuar nga ish Kryetari i Bashkise Berat, me propozim te keshillit mbikqyres i firmosur nga tre antaret me shkresen nr 6342 prot, date 13.11.2017.

Per tre vitet e auditimit me propozim te administratorit , miratim te keshillit mbikqyres dhe vendim te Kryetarit te Asamblese jane percaktuar niveli i pagave te sportistave dhe trajnerave te “ F.K Tomori 1923” sha.,

Per sezonet sportive 2019-2020,2020-2021 dhe 2021-2022 jane lidhur kontrata me sportiste e trajnerat. Jane percaktuar niveli i pagave te sportistave dhe trajnerave me vendime te kryetarit te Asambles. Me Vendim Nr 3, date 17.08.2019 te Asamblese “ Per Miratimin e Struktures se Punonjesve te F.K.Tomori” nr i punonjesve ngelet 10, me ndryshime sipas viteve. Per periudhen e audituar ne te gjitha rastet ndryshimi i strukture bazohej ne vendimet e asamblese te propozuara nga administratori, te miratuara nga keshilli mbikqyres dhe vendimtarja ka qene e Aksionerit te vetem, te perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise.

Nga auditimi i pagave eshte konstatuar se hartimi i tyre eshte kryer mbeshtetur ne te gjithë komponentet e pages bruto mujore per cdo punonjes. Listeprezencat jane nenshkruar nga Administratori. Ne liste pagesa kane gjetur zbatim detyra funksionale, paga, kompesimi ushqimor sipas kontratave te lidhura me cdo futbollist, ku ne kontrate jane percaktuar te drejtat dhe detyrimet per secilin sportist e trajner bazuar ne ligjin 79/2017 “ Per sportin “, me ndryshimet perkatese. Ne cdo kontrate eshte percaktuar paga mujore kompesimi ushqimor si dhe bonusi fillestar dhe kontrata eshte firmosur nga administratori dhe kryetari i asamblese i perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise.

-Rregullorja e brendshme , dosjet e personelit administrativ, trajnereve dhe sportistave:

Nga auditimi i mirefunksionimit sw “ F.K.Tomori 1923” sh.a. u konstatua se nuk egziston rregullorja e brendshme e mirefunksionimit te administrates se F.K.Tomori, ku tw gjejne zbatim funksionimi, struktura organike, ndarja e detyrave dhe pergjegjwsiwe. Ekzistonte vetem rregullorja e brendshme e trajnereve dhe sportistave.

Gjetje nr 3 : Nuk ka rregullore te brendshme te administrates se F.K.Tomori per vitet e auditimit qe perben shkelje te kreut III , nenit 20 te ligjit Nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”i ndryshuar, I cili duhet te gjeje miratim nga organet drejtuese te sh.a.

Rekomandimi nr 3 : Te miratohet rregullore e re e administrates, trajnereve dhe sportistave per mirefunksionimit te F.K.Tomorit dhe te gjej miratim nga nga organet drejtuese te sh.a, konform , nenit 20 te ligjit Nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”i ndryshuar , ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjit Nr.79/2017 “ Per Sportin” i ndryshuar.

- Nga auditimi i dosjeve te personelit ne zbatim në zbatim të VKM nr.117, Date 05.03.2014 “Per permbajtjen, proceduren dhe administrimin e dosjeve te personelit”, u konstatua se nuk ka dosje te personelit te administrates dhe vetem kontrata te lidhura me sportistet dhe trajneret sipas sezoneve futbollistike te firmosura nga sportistet e trajneret, administrator dhe nga aksioneri i vetem themelues, i perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise.

Gjetja Nr 4 : Nuk jane hapur dosjet e personelit nw zbatim në zbatim të VKM nr.117, date 05.03.2014 “Per permbajtjen, proceduren dhe administrimin e dosjeve te personelit”,

Rekomandimi Nr 4: *Nga shefi i finances te merren masat per hapjen dhe plotesimin e dosjeve te personelit, sportistev e trajnereve me te gjithë komponentet e duhur si dhe plotesimin e librit te pagave ne mbeshtetje te VKM nr 117, Date 05.03.2014 “Per permbajtjen, proceduren dhe administrimin e dosjeve te personelit e te rregjistrir qendror te personelit”, Kreu 1, pika 3, Lidhja 1 dhe 2.*

V. Sistemi i realizimit, raportimit dhe ndjekjes se te ardhurave

F.K.Tomori disponon edhe biletat si letra me vlerë nga të cilat duhet të gjenerohen të ardhura, si element shumë i rëndësishëm i ecurisë dhe funksionit të sha-së. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se vetëm për vitin 2021 janë shitur bileta në vlerën 214,000 lekë si më poshtë:

Gjëndja fizike e biletave korrespondonte me gjëndjen kontabël të tyre, në inventarin e vitit 2021 dhe shitjet e kryera gjatë periudhës 01.01.2022 – 28.04.2022. Vihet re se të ardhurat nga shitja e biletave jane shumë të ulta gjatë vitit kalendarik dhe këto te ardhura janë gati të papërfillshme për vazhdimësinë dhe ecurinë e sha F.K.Tomori.

GjetjeNr 5:

- 1. Të ardhurat nga shitja e biletave jane shumë të ulta gjatë vitit kalendarik dhe këto te ardhura janë gati të papërfillshme për vazhdimësinë dhe ecurinë e sha F.K.Tomori.*

Rekomandimi nr 5:

- 1. Nga Sha F.K.Tomori të merren masat dhe të gjenden mundësitë për rritjen e të ardhurave të shoqërisë në kushtet e vazhdimësisë së statusit të saj;*

VI. Sistemi i prokurimeve

Ne procedurat e prokurimit publik te kryer është respektuar ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr 162/2020 “ Per prokurimin Publik”, VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, ndryshuar me VKM nr 918, date 29.12.2014 “ per kryerjen e procedurave te prokurimit publik ne menyre elektronike”, si dhe Udhezimi nr 5, date 11.01.2018” Per nje shtese ne Udhezimin nr 3, dt 08.01.2018 “ Mbi perdorimin e procedures se prokurimit me vlere te vogel dhe zhvillimin e saj me mjete lektronike”.

Nga auditimi u konstatua se mbeshtetur ne Ligjin Nr.182/2014 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9643, Date 20.11.2006, “Per prokurimin publik”, te ndryshuar neni 4, per periudhen e audituar 1 Janar 2019-31 Dhjetor 2021 jane zbatuar kerkesat e Udhezimit Nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrir të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Rregjistrir të Realizimeve të Prokurimit Publik ”pika 4.

Per 3 vitet e auditimit ne F.K.Tomori 1923 kane funksionuar:

-1 Komisioni i percaktimit te f.limit, Komisioni i prokurimit per blerjet me vlere te vogla, komisioni i marrjes ne dorezim te mallrave.

Ndersa ne menyre elektronike jane zhvilluar 3 procedura konform ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Udhezimin nr 3, dt 08.01.2018 “ Mbi perdorimin e procedures se prokurimit me vlere te vogel dhe zhvillimin e saj me mjete lektronike”, pika 4.

Konkretisht: Sherbim transporti 142.800 leke, akomodim hoteli, mengjez + vaktet dreke e darke per Ekipin e Tomorit 400.000 leke .

Per vitin 2020 nga auditimi i procedurave te prokurimit (Fondi eshte i vogel) u konstatua se per blerjet me vlere te vogel nuk ka tejkallim te vleres prej 100000 leke per grup artikut e njejte.

Por nga auditimi u konstatua se per vitin 2019 dhe vitin 2020 jane certifikuar pasqyrat financiare te F.K.Sha nga ekspert kontabel dhe audituesja ligjore ne vleren e 150.000 lekeve per cdo vite ne baze te kerkesave te Ligjit per shoqerite tregtare , por pa procedure te prokurimit ne shkelje te ligjit ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe te Udhezimi nr 5, date 11.01.2018” “ Mbi perdorimin e procedures se prokurimit me vlere te vogel dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 1, ku thuhet “ *Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për mallra, shërbime dhe punë, vlera e përllogaritur e të cilave gjatë vitit kalendarik është nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 800.000 (tetëqind mijë) lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet TVSH-ja* ”

Ne zbatim të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 3 pika 4 gërma ç perkufizon: *"Fondet publike" janë të ardhura nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit"* dhe u nenshtrohen procedurave te prokurimit publik.

Gjetje Nr 6: Nuk është zhvilluar procedura prokurimi për certifikimin e pasqyrave financiare nga audituesit ligjore individual ose shoqëri audituese ligjore

Rekomandimi nr 6: Nga Sh.a F.K.Tomori, në përzgjedhjen e audituesve ligjorë të zbatohet Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"; si dhe në ftesën për oferte në mënyrë elektronike të drejtohet për oferte të pakten 5

audituesve ligjorë ose shoqëritë audituese, vendose e të huaja, të cilat janë regjistruara si të tilla në zbatim të Udhezimit nr 5, datë 11.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 9.

Në procedurën e prokurimit publik me vlerë të vogël u kontaktuan këto të meta e parregullsi:

-Urdhër Prokurimi Nr 4, datë 21.09.2020 e administratorit për prokurimin me vlerë të vogël me fond limit 100 mijë leke objekt "Blerje 2 porta të medha për stervitje me permasa 2,47m x 7,1m e kompletuar".

Egziston kërkesa për blerjen e 2 portave me permasa 2,47m x 7,1" nga trajneri Bledar Shulla. Miratuar nga Administratori Ismet Ajazi. Procedura e drejtpërdrejtë shkresore. Ekziston fatura tatimore me tvsh nr 633, datë 22.09.2020 e sipërmarësit "Bejko" shpk me vlerë 32.400 leke me tvsh.

Eksrakti i QKR i njëjtit me aktivitetin. Proces verbal i komisionit të marrjes në dorezim nga Emirjan Idrizi, Altin Alldri dhe Elton Fani.

Si parregullsi u konstatua se nuk përcaktohet në specifikimet teknike përberja e materialit (material metalik apo druri), trashësia e materialit, forma, si dhe ngjyra .

Gjetje nr 7: Në procedurën "Blerje dy porta të medha për stervitje me permasa 2,47m x 7,1m e kompletuar", nuk përcaktohet në specifikimet teknike si:

-Përberja e materialit (material metalik apo druri),

-Trashësia e materialit,

- Forma, si dhe ngjyra .

Veprimi e mesipërmben përshkelje të ligjit të prokurimit publik e konkretisht shkelje të pikës 5 të Udhezimit nr 3, datë 8.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku thuhet: "Përpara nxjerrjes së urdhrës të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përlllogarit fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Rekomandimi nr 7: Të hartohen specifikimet teknike përpara nxjerrjes së urdhrës të prokurimit në zbatim nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

VII. Sistemi i inventarizimit e i raportimit financiar.

-Procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve.

U auditua procedura e inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve për vitin 2019, 2020 dhe 2021 të hartuar nga shoqëria në mbështetje të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhezimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Mangesitë e konstatuar nga auditimi i procedurës së inventarizimit – vlerësimit për vitet 2019-2021 janë hartuar duke gërshtuar statusin e shoqërisë në formën e shoqërisë aksionere e cila ka në fokus zbatimin e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe legjislacionin publik për shkak të zotërimit 100% të kapitalit aksionar në administrim të Bashkisë Berat si fonde publike, si më poshtë:

1-Në të treja periudhat e inventarizimit-vlerësimit, urdhërat e brendshëm janë ngritur nga administratori i shoqërisë në zbatim të nenit 158 pika 3 gërma a të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, por në urdhërin e komisionit të vlerësimit, kryetari i këtij komisioni duhet të jetë nëpunësi zbatues në zbatim të pikës 99 të Udhezimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar që citon: "Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxhere ose specialistë të financës si dhe specialiste të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nepunësi Zbatues i njësisë. Nepunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit.."

2-Administratori i shoqërisë nuk mund të jetë pjesë përbërëse e komisioneve të procedurës së inventarizimit vlerësimit, në zbatim të nenit 158 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ku përcaktohen detyrat dhe të drejtat e administratorëve; 3-Në të treja periudhat e inventarizimit vlerësimit me urdhër të brendshëm të titullarit të sha komisionet e asgjësimit janë ngritur në kundërshtim me pikën 100 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, të ndryshuar, i cili shprehet “Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari..”; 4-Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë një proces verbal vlerësimi dhe një relacion vlerësimi për të bërë me dije administratorin në lidhje me gjithë procedurën e vlerësimit të aktiveve në zbatim të pikave 105-106 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, të ndryshuar;

Gjetje nr 8:Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit është ngritur nga administratori i sha në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, të ndryshuar;

Gjetje nr 9:Në urdhërat e komisioneve të vlerësimit, kryetari i komisionit të vlerësimit nuk është nëpunësi zbatues dhe administratori i shoqërisë është pjesë përbërëse e komisioneve të procedurës së inventarizimit vlerësimit;

Rekomandimi nr 8: Nga sha F.K.Tomori në ngritjen e urdhërave për komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit të zbatohet me korrektësi pika 100 e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, të ndryshuar;

Rekomandimi nr 9: Nga sha F.K.Tomori në ngritjen e urdhërit për komisionin e vlerësimit të zbatohet me korrektësi pika 99 e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe administratori nuk mund të jetë pjesë përbërëse e komisioneve në zbatim të nenit 158 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar,;

Sistemi i kontabilitetit dhe i raportimit financiar

U audituan pasqyrat financiare të vitit 2019, 2020 dhe 2021 të cilat në zbatim të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, se brenda datës 31 Mars 2020/2021/2022, duhet të dorëzojnë Deklaratën e pagesës së tatimit mbi fitimin dhe pasqyrave financiare për vitin 2019/2020/2021. Mbështetur në Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" neni 3, pika 18 dhe Ligjit nr. Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar neni 7 pika 2 shprehet “Organizata profesionale e audituesve ligjorë grupon të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, vendase e të huaja, të cilat janë regjistruar të tilla, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara, të shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë.”. Për sa më sipër, pasqyrat financiare të SHA F.K.Tomori duhet të jenë të certifikuar nga auditues ligjor ose shoqëri auditimi.

Për të dyja vitet 2019 dhe 2020, përveç hartimit të pasqyrave nga ekonomisti i sha F.K.Tomori, pasqyrat janë certifikuar nga audituesit ligjor Bujar Osmani dhe Lefteri Kusta të cilët kanë hartuar raportin e “Audituesit ligjor për auditimin e Bilancit të vitit 2019” dhe raportin e “Audituesit ligjor për auditimin e Bilancit të vitit 2020” Për vitin 2021 pasqyrat financiare janë hartuar nga ekonomisti i sha F.K.Tomori, miratuar nga administratori por ende nuk janë certifikuar nga auditues ligjorë për shkak të afatit të deklarimit të tyre i cili daton më 31 Korrik. Vendimi për audituesit ligjor është marrë nga asambleja e përgjithshme por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ngelet i paqartë mënyra e përzgjedhjes dhe tarifimi i tyre, (trajtuar tek kapitulli VI, prokurimet) Deklaratat e tatimit fitimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të deklaruara në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve. Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2019, 2020 dhe 2021 u vërejt se ka anomali me deklaratën e tatimit fitimit të raportuar.

Për vitin 2019 në Pasqyrën e Performancës janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit në të cilin

pasqyrohet fitimi i periudhës në vlerën 320,835 lekë. Në pasqyrën e pozicionit financiar, në formatin e pasivit është e pasqyruara vlera prej -9,333,272 lekë si humbje të pashperndara të viteve të kaluara. Në zbatim të nenit 27 Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar qe shprehet: "Mbartja e humbjeve 1. Në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e parë më përpara se ajo e fundit"." Në deklaratën tatimore të vitit 2019, është raportuar si humje vlera prej 1,762,880 lekë, vlerë e cila nuk gjendet tek pasqyra e pozicionit financiar. Për vitin 2020 në Pasqyrën e Performancës janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit në të cilin pasqyrohet fitimi i periudhës në vlerën 685,537 lekë. Ne pasqyrën e pozicionit financiar, ne formatin e pasivit është e pasqyruara vlera prej -9,012,437 leke si humbje të pashperndara të viteve të kaluara, vlerë e cila nuk është raportuar ne deklaratën tatimore të vitit 2020, nga e cila është gjeneruar pagesa e tatim fitimit në vlerën 146,300 lekë.

Për vitin 2021 në Pasqyrën e Performancës janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit në të cilin pasqyrohet fitimi i periudhës në vlerën 3,575,811 lekë. Ne pasqyrën e pozicionit financiar, ne formatin e pasivit është e pasqyruara vlera prej -8,326,900 leke si humbje të pashperndara të viteve të kaluara, vlerë e cila nuk është raportuar në deklaratën tatimore të vitit 2021, nga e cila është gjeneruar pagesa e tatim fitimit ne vlerën 546,623 lekë.

Ne gjykimin e auditit, për te treja periudhat e audituara, u konstatua se janë trajtuar si të "ardhura" dhe si detyrim të pagesës së tatim fitimit (përvec vitit 2021 qe ka të ardhura edhe nga shitja e biletave dhe e lojtarit) të gjitha derdhjet/cashi që i vijnë SHA F.K.Tomori -se nga Bashkia Berat në statusin e aksionerit të vetëm në pronësi të aksioneve, 100% të tyre. Anomalia e trajtimit të hartimit të pasqyrave financiare është struktura e shoqerisë e cila është shoqeri aksionere që trajtohet nga legjislacioni tatimor i sipercituar por vazhdimësia dhe ecuria e kësaj shoqerie është me fonde publike të administruara nga Bashkia Berat.

Koncepti i te ardhurave është i percaktuar nga Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara nr. 8: "Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital)." Fondet janë të përjashtuara në zbatim të nenit 18 germa a të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, e cila shprehet "Përfshijet-Përfshihen nga tatimi mbi fitimin: a)organet e qeverisjes qendrore dhe vendore;". Të ardhurat që Bashkia Berat i jep sh.a.-së janë të ardhura të ushtrimet dhe nuk mund të klasifikohen si të ardhura tatimore.

Përdorimi i bazës materialeve dhe nxjerrja nga magazina

Nga auditimi i dokumenteve të magazinës rezultoi se për periudhën e audituar, fletë - daljet janë hartuar nga magazinieri dhe tërheqësi i bazës materiale pa urdhër dorëzimin e lëshuesit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësive të sektorit publik", i ndryshuar pika 35.

Gjetje nr 10: Magazineri ka hartuar fletë daljet pa urdhër dorëzimin, i cili është dokumentacion autorizues që lejon kryerjen e një veprimi ekonomik;

Gjetja nr 11: Të ardhurat në pasqyrat financiare, të cilat janë fondet publike të Bashkisë Berat, janë trajtuar si të ardhura tatimore në kuptimin e "përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël";

Rekomandimi nr 10: Financa e Sha F.K.Tomori duhet të shohë plotësinë e dokumentacionit të daljes së bazës materiale në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësive të sektorit publik", i ndryshuar pika 35;

Rekomandimi nr 11: Nga Sha F.K.Tomori, të zbatohet me korrektësi legjislacioni tatimor dhe ai publik në hartimin e pasqyrave tatimore në pasqyrimin e plotë dhe të saktë të burimit të të ardhurave ne zbtim te SKK nr. 8 dhe neni 18 germa a te Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;

Në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 12, pika d, "Përgjegjësitë e titullareve të njësive publike" për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit rezulton se janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e auditit të brendshëm.

Nga “F.K.Tomori 1923 ” është dërguar Plani i Veprimit mbi zbatimin e Rekomandimeve të Auditit të Brendshëm, dërguar Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat date 03.07.2022, brenda afatit 1(një) muhor nga dërgimi i Raportit Final të Auditimit, ku janë pranuar të gjitha rekomandimet, personat përgjegjës mbi zbatimin e tyre si dhe afatet e realizimit.

Duke Ju falenderuar,

AUDITI I BRENDSHËM

Xhevahir MUZHAKA

Orieta HYSANJ